



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republika e Kosovës

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023) si dhe Nenit 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr.7/01mars 2019), dhe Rregulloren (AKA) Nr.02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG), Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) miraton këtë:

RREGULLORE (AKA) NR.05/2024 PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM

Gusht 2024

Faqe 1 nga 5

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe kriteret për vlerësimin e brendshëm të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) pas procedurave të vlerësimit të jashtëm dhe për trajtimin e të gjeturave nga rezultatet e pyetësorëve. Objektivi kryesor është të sigurohet një proces transparent dhe efektiv për përmirësimin e cilësisë dhe funksionalitetit të AKA-së.
2. Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, AKA do të organizojë procedurat e vetëvlerësimit - vlerësimit nga hisedarët.
3. Ky dokument do të shërbejë si udhërrëfyes për AKA-në, institucionet e arsimit të lartë dhe hisedarët e tjerë, në zbatimin e procedurave të drejta dhe transparente të vlerësimit të jashtëm.
4. Ky dokument i përmbush Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015), që kërkojnë nga agjencitë e sigurimit të cilësisë të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të institucioneve të arsimit të lartë të vendosin procedurat dhe standardet e akreditimit/riakreditimit. Përmes kësaj rregulloreje AKA prezanton procedurat dhe standardet e vlerësimit të cilat përshtaten me kontekstin e sistemit të sigurimit të cilësisë në Kosovë, në përputhje me legjislacionin vendor në fuqi dhe standardet evropiane të arsimit të lartë.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Agjencia e Kosovës për Akreditim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë (IAL) dhe hisedarët e tjerë.

Neni 3

Përkufizime

1. **AKA:** Agjencia e Kosovës për Akreditim.
2. **IAL:** Institucioni i Arsimit të Lartë.
3. **MASHTI:** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
4. **Pyetësorë:** Dokumente që përmbajnë pyetje të strukturuar dhe që grumbullojnë informacion mbi performancën dhe efektivitetin e AKA-së.

Faqe 2 nga 5

Neni 4

Komisioni i Vlerësimit:

1. AKA formon një komision për hartimin, shpërndarjen dhe mbledhjen e pyetësorëve, analizimin e të dhënave dhe vlerësimin e performancës së AKA-së.
2. Komisioni themelohet me vendim të drejtorit të përgjithshëm të AKA-së dhe përbëhet nga 5 anëtarë.
3. Njëri nga anëtarët do të shërbejë si sekretari e komisionit dhe do të menaxhojë dokumentacionin, do të koordinojë takimet, do të mbajë evidencë të të gjitha aktiviteteve të lidhura me vlerësimin dhe administrimin e pyetësorëve.

Neni 5

Procedurat e Vlerësimit

1. Mbledhja e Informacionit

- 1.1. Pyetësorët do të dërgohen tek hisedarët e arsimit të lartë pas përfundimit të vlerësimit të jashtëm.
- 1.2. Informacioni do të grumbullohet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale nga Sekretaria e Komisionit.

2. Analiza e të dhënave

- 2.1. Komisioni i Vlerësimit do të analizojë përgjigjet e pyetësorëve për të identifikuar përparësitë dhe mangësitë e AKA-së.
- 2.2. Të dhënat do të përpunohen për të hartuar një raport të detajuar mbi performancën e AKA-së.

3. Raporti i Vlerësimit

- 3.1. Një raport përfundimtar do të përgatitet nga komisioni dhe do të përmbajë analizën e të dhënave, gjetjet kryesore dhe rekomandimet për përmirësim.
- 3.2. Raporti do t'i dërgohet për shqyrtim drejtorit të përgjithshëm dhe Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Neni 6

Trajtimi i të gjeturave dhe përmirësimi

1. Planifikimi i Përmirësimit

- 1.1. Komisioni do të hartojë një plan për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportin e vlerësimit.
- 1.2. Plani i përmirësimit do të përfshijë objektiva të qarta, aktivitete, kosto dhe afate kohore për implementim.

2. Monitorimi

- 2.1. Komisioni do të përcjellë zbatimin e planit të përmirësimit dhe do të organizojë takime të rregullta për të vlerësuar progresin.

3. Rivlerësimi

- 3.1. Të paktën një herë në vit AKA-ja do të organizojë procesin e vetëvlerësimit për të përcaktuar efektivitetin e përmirësimeve të implementuara.
- 3.2. Ky proces do të përsëritet në përputhje me planin vjetor të punës të paraparë në dokumentin "Politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim".

Neni 7

Dispozitat specifike

- **Konfidencialiteti:** Të gjitha informacionet e mbledhura gjatë procesit të vlerësimit do të trajtohen si konfidenciale.
- **Pjesëmarrja e Palëve:** Të gjitha palët e interesuara do të ftohen të kontribuojnë dhe të japin opinione gjatë procesit të vlerësimit dhe përmirësimit.
- **Përditësimi i Rregullores:** Kjo rregullore do të rishikohet çdo 3 vjet për të reflektuar ndryshimet dhe nevojat e reja në procesin e vlerësimit.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

(Hyrja në fuqi)

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data e miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i AKA-së.

Naim Gashi

Drejtor i Përgjithshëm i AKA

Prishtinë 28.08.2024